



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E GRAÇANICËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Graçanicës*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Xhevat Seferi - Udhëheqës Ekipi dhe Stana Danqetoviq e Nebojsa Ristiq anëtar të ekipit*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Qeverisja e mirë.....	22
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	30
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	32

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 22/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

Vlera e pasurive jo financiare, e shpalosur në PFV nuk është e saktë. Kjo si pasojë e mos regjistrimit të tokave dhe objekteve në regjistrin e pasurisë si dhe gabimet në regjistrimin e pasurive të blera në vitin 2018 (mos regjistrimi i tyre); dhe

Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht vlera prej 179,274€ që për nga natyra janë mallra/shërbime. Po ashtu, vlera prej 279,972€ të paguara përmes pagesave direkte nga Thesari dhe vendimeve gjyqësore, janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale, derisa i takonin kategorisë për mallra dhe shërbime.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Komuna ka arritur të identifikoj pasurinë komunale, mirëpo përkundër rekomandimeve të ZKA, si dhe përpjekjeve të Komunës për të kryer regjistrimin dhe vlerësimin e gjithë pasurisë, kjo ende nuk është zbatuar plotësisht. Komisioni i formuar për regjistrimin e pasurisë kishte përgatitur një listë të pronave të regjistruara në emër të komunës, megjithatë regjistri i pasurisë ende nuk është i plotë. Më tutje menaxhmenti ende nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e të gjitha tokave dhe objekteve

të trashëguara dhe përfituara në vitet e mëparshme në mënyrë që t'i regjistrojë në regjistrin e pasurisë, si dhe të bëj zhvlerësimin e tyre në fund të vitit. Po ashtu, Komuna nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria për pasurinë nën 1000€; dhe

Shpenzimet totale prej 179,274€ për "Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve" ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale, derisa natyra e shërbimit ishte e mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, shpenzimet përmes pagesave direkte nga Thesari dhe vendimeve gjyqësore në vlerë prej 279,972€, janë klasifikuar gabimisht në kategori ekonomike. Këto shpenzime janë paguar nga Investimet Kapitale, derisa për nga natyra i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime. Shpenzimet, kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtje dhe pastrim, furnizim për zyre derivate etj.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

Një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve kontingjente të pa përcaktuara në vlerë (të prezantuara në raportin e avokatit komunal), mund ta vej komunën në vështirësi financiare në rast se paditë gjyqësore vendosen në favor të palëve paditëse.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Graçanicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe



---

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore dhe mujore për faturat e papaguara dhe të hyrat; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara.

Lidhur me PFV, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, të cilat janë përmirësuar në PFV finale. Megjithatë, sfiduese mbetet çështja e regjistrimit të pasurisë dhe klasifikimi i gabuar i shpenzimeve në kategori ekonomike.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

---

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepen rekomandimet:

**Rekomandimi B1** <sup>1</sup>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në shpalosjen e saktë të vlerës së pasurive, detyrimeve kontingjente dhe llogarive të arkëtueshme në PFV.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2019, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.

---

<sup>1</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatën buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet kanë filluar të përmirësohen, veçanërisht në fushën e procedurave të prokurimit. Megjithatë, një sërë fushash kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Në vitin 2018, komuna kishte një performancë të mirë buxhetore, ku 91% e buxhetit final ishte shpenzuar, që paraqet një ngritje prej 5% krahasuar me atë të vitit paraprak.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë të përshtatshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i personelit, menaxhimi i subvencioneve, si dhe performanca e dobët në arkëtimin e borxheve nga debitorët, ku niveli i tyre është duke u rritur në vazhdimësi.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,484,556	8,390,828	7,652,622	6,694,513	6,172,301
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,805,473	5,924,707	5,898,108	5,346,845	4,685,978
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	-	777,198	747,505	284,851	409,089
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,653,463	1,653,463	997,488	985,564	1,033,288
Financimi nga huamarrja	25,620	25,620	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	9,840	9,521	77,253	43,946

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 906,272€ Kjo rritje është rezultat i bartjes së fondeve nga Të hyrat vetanake të vitit të kaluar në shumën prej 777,198€, grantit qeveritar të rritur për 119,234€, si dhe pranimet nga donatorët e jashtëm për 9,840€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final me një suficit prej 738,206€. Në krahasim me vitin 2017 ka një përmirësim prej 5% (në vitin 2017 realizimi ishte 86%), që është një tregues i mirë i realizimit të buxhetit. Megjithatë, shpenzimet e buxhetit nuk kanë pasur trend të mirë në planin e rrjedhës së pagesave (cash flow) pasi në tre muajt e fundit shpenzimet ishin 3,155,451€ apo 41% e shpenzimeve vjetore.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,484,556	8,390,828	7,652,622	6,694,513	6,172,301
Pagat dhe Mëditjet	2,863,925	2,833,159	2,833,159	2,702,541	2,645,027
Mallrat dhe Shërbimet	723,706	755,974	729,506	774,503	936,115
Shërbimet komunale	150,000	160,297	137,764	139,702	126,106
Subvencionet dhe Transferet	180,859	224,025	209,567	183,451	281,574
Investimet Kapitale	3,566,066	4,417,373	3,742,626	2,894,316	2,183,479

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

Me vendim të Qeverisë kishte shkurtim të buxhetit të kategorisë së pagave dhe mëditjeve për 30,766€. Ndërsa ndryshimet (rritjet) tjera nëpër kategori, janë tek investimet kapitale në vlerë prej 851,307€, të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ka rritje për 32,268€, të subvencionet për 43,166€ dhe të shërbimet komunale për 10,297€.

---

**Çështja A1 – Pagesat direkte nga Thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore****Gjetja**

Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Si rezultat i mos pagesës së obligimeve me kohë, procesi i menaxhimit të buxhetit nga komuna në vitin 2018 ka qenë sfidues, duke marr parasysh se një shumë e konsiderueshme e shpenzimeve në vlerë 293,293€ është ekzekutuar nga pagesat direkte të Thesarit sipas nenit 39.2 dhe sipas nenit 40 të LMFPP. Shpenzimet, kryesisht kanë të bëjnë për mirëmbajtje dhe pastrim, furnizim për zyre, derivate, dru etj.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka hyrë në obligime pa pasur buxhet për furnizimet apo shërbimet e bëra.

**Rreziku**

Dobësitë në menaxhimin e shpenzimeve, rezultojnë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, si dhe reduktojnë efektivitetin e planeve të shpenzimeve të komunës. Ndërsa, pagesat direkte nga Thesari, janë domethënëse për buxhetin e komunës dhe ndikojnë në lëkundje të bilancit buxhetor. Kjo rrit rrezikun për pagesa shtesë, jashtë kodeve të planifikuara dhe mos realizimin e projekteve për shkak të ridestinimit të shpenzimeve buxhetore.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj, duhet të përmirësohet menaxhimi i shpenzimeve për tu siguruar se ato kryhen sipas afateve ligjore për të evituar shpenzimet shtesë përmes procedurave gjyqësore.

## Çështja C1 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas ligjit LMFPP është përcaktuar se të gjitha shpenzimet duhet të kryhen sipas Planit kontabël në kategori dhe kode adekuate. Ky plan azhurnohet çdo vit kur ka ndryshime të kodeve ekonomike (futje apo heqje të tyre).

Pagesat në vlerë prej 279,972€ të cilat janë ekzekutuar direkt nga Thesari dhe vendimeve gjyqësore janë bërë nga Investimet kapitale derisa për nga natyra janë mallra dhe shërbime.

Po ashtu, pagesat për “Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve” në vlerë 179,274€, ishte bërë gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale derisa natyra e shërbimit ishte e mallrave dhe shërbimeve dhe si e tillë ishte buxhetuar gabimisht.

Kjo ka ndodhur për shkak të sfidave në planifikimin dhe aprovimin e buxhetit, që ka reflektuar në mjete të pamjaftueshme në kategori të caktuara ekonomike.

**Rreziku** Pagesat nga kode të gabuara ekonomike mund të ndikojnë në paraqitje jo të drejtë të informatave dhe raportim a po klasifikim jo të saktë të dhënave në PFV, që shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës. Përveç kësaj përdorimi i fondeve të një kategorie të shpenzimeve për shpenzime të kategorisë tjetër do të ndikojnë në implikime buxhetore të komunës.

**Rekomandimi C1** Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t’i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj, planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari për të evituar një raportim dezorientues për shfrytëzuesit e PFV-ve.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2018 ishin në vlerë 1,531,242€ dhe në krahasim me vitin paraprak janë realizuar 113,312€ më pak. Burimet e arkëtimit direkt të hyrave vetjake janë nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë 67,063€ dhe gjobat në vlerë 155€.

Shpjegimet për planifikimin dhe realizimin e të hyrave janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,653,463	1,653,463	1,531,242	1,644,554	1,354,272
<b>Total të hyrat</b>	<b>1,653,463</b>	<b>1,653,463</b>	<b>1,531,242</b>	<b>1,644,554</b>	<b>1,354,272</b>

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshinë: hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Financave. Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 2,833,159€ dhe po aq edhe ishin shpenzuar.

---

**Çështja B2- Marrëveshjet me kontratë për shërbime të veçanta****Gjetja**

Sipas Udhëzimit Administrativ (MLSH) Nr.01/2018 për përcaktimin e stafit ndihmës për komuna, neni 4, thuhet: "Për të siguruar asistencë teknike, kryetari i komunës mund të caktojë katër (4) zyrtar mbështetës në zyrën e tij - shefin e kabinetit, Zyrtarin për marrëdhënie me publikun, Zyrtarin Administrativ dhe Zyrtarin e Logjistikës (vozitës).

Komuna, kishte angazhuar 11 (njëmbëdhjetë) punëtorë me marrëveshje për shërbime të veçanta në cilësinë e këshilltarëve komunal, ku kontrata ju vazhdohet çdo gjashtë muaj. Këta këshilltarë janë caktuar për të dhënë këshilla në fushën e financave, administratës, rinisë dhe sporteve, për të bashkëpunuar me komunitetet jo-shumicë etj. Përveç kësaj, njëri prej tyre është në detyrë të këshilltarit të kryetarit që nga viti 2015. Komuna për këto shërbime gjatë viti 2018 ka paguar 41,146€. Më tutje, komuna për këta të punësuar nuk kishte aplikuar procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.

Po ashtu, në vitin 2015, komuna ka angazhuar avokatin për të përfaqësuar komunën në të gjitha kontestet gjyqësore për një periudhë të pacaktuar kohore. Komuna ka një nëpunës civil për çështje ligjore, por nuk kryen punën e përfaqësimit në procese gjyqësore, megjithatë, sipas rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, neni 13 thekson që kreu i shërbimit juridik duhet të përfaqësojë komunën në gjykata si dhe organe të tjera.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka respektuar rregullat dhe kuadrin ligjor për angazhimin e individëve për shërbime të veçanta. Në anën tjetër, kjo është ndikuar edhe për shkak të funksionit jo të mjaftueshëm të zyrës për çështje ligjore në komunë. Ndërsa, për angazhimin e këshilltarëve, sipas menaxhmentit kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka nevojë për këta punëtor dhe nuk ka të aprovuar punëtorë të mjaftueshëm për këto pozita.

**Rreziku**

Mbulimi i pozitive të rregullta me kontrata për shërbime të veçanta duke vazhduar për vite me radhë, nuk është në pajtim me rregulloret dhe rritë pasigurinë e stafit për qëndrim të gjatë në këto pozita, çka mund të reflektoj edhe në performancë dhe monitorim të dobët të stafit.

**Rekomandimi B2**

Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar. Në këtë mënyrë do të mënjanohej kërkesat për kontrata për shërbime të veçanta që mund të kalojnë periudhën e përcaktuar.



### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 755,974€ dhe prej tyre ishin shpenzuar 729,506€. Komuna gjithashtu për shërbime komunale ka buxhetuar 160,279€, ndërsa ka shpenzuar 137,764€. Shpenzimet nga kjo kategori kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje, shërbime komunale etj).

#### Çështja C 2 - Monitorimi jo i duhur i marrëveshjes

**Gjetja** Komuna, kishte lidhur marrëveshjen me KRM "Pastrimi" sh.a, për ofrimin e shërbimeve komunale "Bartja e mbeturinave" (11,573€) si dhe "Mirëmbajtja e higjienës publike" (13,494€). Sipas marrëveshjes, shpenzimet mujore për kryerjen e këtyre dy shërbimeve arrijnë vlerën 25,067€. Marrëveshja është nënshkruar për kohë të pa caktuar.

Me marrëveshje ishte përcaktuar se, komuna do të mbaj një regjistër të shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve për tërë territorin e komunës së Graçanicës dhe se komuna do të arkëtoj të hyrat për këto shërbime, megjithatë kjo nuk ka ndodhur. Për më tepër, komuna i paguan KRM "Pastrimi" për pjesën që kjo nuk arrin ta arkëtoj nga qytetarët dhe nga institucionet publike dhe jo publike. Në anën tjetër, komuna për këto shërbime nuk ka mjete të buxhetuara, derisa shpenzimet paguhen përmes pagesave direkte nga Thesari nga investimet kapitale sipas kërkesës së komunës. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos planifikimit të buxhetit për këto shërbime.

**Rreziku** Marrëveshjet e tilla pa u zbatuar të drejtat dhe detyrimet nga secila palë dhe pa monitorim nga ana e komunës, paraqesin rrezik që mjetet e dhëna të mos arrijnë qëllimin e caktuar, dhe zvogëlon sigurinë që marrëveshja është realizuar konform kushteve dhe specifikave të parapara. Po ashtu mos buxhetimi i mjeteve për këto shërbime dhe pagesat nga kategoria e investimeve kapitale e vë komunën në vështirësi dhe rrezikon mos realizimin e projekteve kapitale.

**Rekomandimi C2** Kryetari, duhet të sigurojë monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes, ashtu që të ketë një raport të detajuar mbi shërbimet e kryera në mënyrë që të shtojë sigurinë tek menaxhmenti se marrëveshjet po realizohen konform kushteve të kontraktuara. Në anën tjetër, kryetari duhet të siguroj doemos, që për zbatimin e marrëveshjes të siguroj mjetet e mjaftueshme buxhetore me rastin e planifikimit të buxhetit, në të kundërtën marrëveshja si e tillë nuk mund të jetë e zbatueshme sipas rregullave të përcaktuara buxhetore.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 224,025€. Prej tyre, në vitin 2017 ishin shpenzuar 209,567€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve jo publike për t'i mbështetur aktivitetet sportive-kulturore, rastet sociale, subvencionimet në bujqësi, etj.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,417,373€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 3,742,626€ ose 85% e buxhetit, për dallim nga viti i kaluar (74%) ka përmirësim të dukshëm të ekzekutimit të buxhetit. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës në shëndetësi, arsim, si dhe infrastrukturës rrugore.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë janë një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre, si dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

---

### Çështja B3 - Mos aplikimi i sistemit e-pasuria

**Gjetja** Sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuritë kapitale me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet evidentohen në sistemin e-pasuria.

Komuna nuk aplikonte sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria) që t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000€, përfshirë pasurinë, materialet shpenzuese, etj. Për këtë qëllim komuna mban një listë të brendshme (regjistër në Excel).

Kjo ka ndodhur për shkak se aplikacioni E-pasuria nuk ishte funksionale për probleme gjuhësore. Komuna ka ndërmarrë hapa me Ministrinë relevante (MAP /MAPL) për këtë çështje, megjithatë ende kjo mbetet e pa përfunduar.

**Rreziku** Mos aplikimi i sistemit e-pasuria vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo po ashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.

### 3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta, janë fond i vogël i parave që mbahen në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njërive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishin në vlerë prej 2,786,417€, ndërsa në vitin 2018 ishin 3,128,040€ dhe tregojnë trend të rritjes së këtyre llogarive. Kjo është për shkak të politikave joefektive që janë zbatuar nga menaxhmenti dhe për shkak të mungesës së një strategjie për mbledhjen e këtyre borxheve.

Struktura e këtyre llogarive përbëhet nga të arkëtueshmet për tatimin në pronë në vlerë prej 2,120,482€, nga shpronësimi i tokës 671,855€, tatimi i biznesit 280,765€, qiraja 48,474€, dhe nga taksat e inspektimit 6,460€.

Komuna ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse. Megjithatë edhe më tutje sistemi i kontrollit duhet të forcohet, për të parandaluar rritjen e të arkëtueshme nga viti në vit dhe vlera e tyre të ulet në një shkallë të pranueshme.

#### Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve

**Gjetja** Komuna nuk ka ndonjë plan për mbledhjen e të arkëtueshmeve, dhe nuk ka marrë ndonjë veprim konkret për arkëtimin e tyre përmes përmbaruesit.

Llogaritë e arkëtueshme deri tani janë prej 3,128,040€, sipas të dhënave të Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Financave, të arkëtueshmet nga viti në vit vazhdojnë trendin e rritjes. Gjithashtu, pretendimet në emër të taksave të biznesit janë gjithashtu në vitin 2018 për 66% në krahasim me vitin 2017.

Mungesa e intervistuesve dhe inspektorëve të stafit, përditësimi i parregullt i bazave të të dhënave dhe mbajtja joadekuate e shënimeve të faturimit, për të arkëtueshmet kanë çuar në rritje të kërkesave nga viti në vit.

**Rreziku** Mungesa e mekanizmave dhe kontrolleve adekuate rrit rrezikun e rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive, duke rezultuar në fonde më të vogla për arritjen e qëllimeve dhe mos inkurajimin e debitorëve të tjerë që të përmbushin detyrimet e tyre.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të analizojë arsyet për trendin në rritje të arkëtueshmeve të tatimit në pronë dhe për të forcuar kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Është e nevojshme të krijohet një strategji dhe mekanizma për të mundësuar identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluar përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në evidencën e tatimit në pronë të paguar. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë llogaritë e arkëtueshme të taksës së biznesit, në mënyrë adekuate.

### 3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 232,035.43€ derisa në fund të vitit 2017 ishte 156,562€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Çështjet lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Vëmendje e shtuar e menaxhmentit nevojitet në proceset për adresimin e rekomandimeve të auditimit dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk janë të vendosura, ndërsa Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontroleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Komuna kishte plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit dhe kishte një përmbajtje më pozitive në raport me vitin paraprak.

Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit socio-ekonomik lokal 2017-2021 konsiderohet se është e vendosur pjesërisht nga ana e komunës, për arsye se strategjia ishte draft e cila nuk është miratuar, dhe si e tillë nuk ka mundur të gjej zbatim nga ana e komunës. Po ashtu, komuna ka edhe plane tjera funksionale si: plani për integritet 2016-2020, Programi i mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë 2014-2029 (në bashkëpunim me UN HABITAT dhe SDC), Plani operativ i punës për 2017, Plani operativ i Inspektionit 2017 etj.

---

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me staf prej dy anëtareve – Udhëheqësi i NjAB dhe një auditor. Një NjAB efektive kërkon një program gjithë përfshirës pune i cili pasqyron rreziqet financiare dhe rreziqe të tjera të Komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Ndikimi i rezultateve të NjAB-se duhet të gjykohet bazuar në rëndësinë që menaxhmenti i jep adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfidat që ofrohen nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2018, ishin planifikuar dhe realizuar gjashtë auditime. Planet ishin bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Komiteti të Auditimit, si organ i pavarur dhe këshillëdhënës për menaxhmentin i cili thirret për të ndihmuar kontrollin e brendshëm në komune, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjashtë takime, ku ishin diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së.

---

### Çështja B5 – Niveli i ultë i zbatimit të rekomandimeve

**Gjetja** Në raportet e auditimit nga NjAB janë dhënë gjithsej 24 rekomandime ku niveli i zbatimit të tyre ishte mjaftë i ulët pas vetëm një ishte zbatuar plotësisht 17 ishin në proces dhe 6 nuk janë trajtuar fare nga menaxhmenti.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së fokusit dhe angazhimit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet të zbatohen nga komuna me kohë.

**Rreziku** Adresimi i dobët i rekomandimeve të NjAB-së dhe mos hartimi i planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve për të gjitha subjektet e audituara nga ana menaxhmentit rritë rrezikun se kontrollet e brendshme nuk janë duke funksionuar në nivelin e duhur.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

---

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja B6 -Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**Gjetja** Menaxhimi jo i duhur i proceseve të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në veçanti në lidhje me realizimin e buxhetit për investime kapitale, regjistrimin dhe raportimin e pasurive si dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Më tutje, menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, si dhe nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive ndonëse ka marrë iniciativë për të punuar në hartimin e regjistrit të rreziqeve, mirëpo ende nuk ka rezultate/veprime konkrete. Kjo përbën mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e rreziqeve.

**Rreziku** Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar të cilësisë së pamjaftueshme, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta dhe shërbimeve jo cilësore.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.



## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 ka rezultuar me 11 rekomandime. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit tonë, nga 11 rekomandime të dhëna, vetëm dy (2) ishin zbatuar plotësisht, dy (2) rekomandime ishin pjesërisht të zbatuara, gjashtë (6) të pa zbatuara dhe një rekomandim i mbyllur i pazbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Vjetore Financiare	<p>Kryetari , duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në shpalosjen e saktë të vlerës së pasurive, detyrimeve kontingjente dhe llogarive të arkëtueshme në PFV.</p> <p>Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV- ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	<p>Ky rekomandim kishte të bënte me mangësitë e gjetura lidhur me menaxhimin e pasurisë që kanë ndikuar në theksim të çështjes tek opinionin i auditimit. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete.</p>	Rekomandim i pa zbatuar.

2	<p>Procesi i buxhetit</p> <p>Çështja - Niveli i ulët i realizimit të buxhetit si dhe keq-klasifikim i shpenzimeve.</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundojnë sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.</p>	<p>Këtë vit ka progres të theksuar në realizimin e buxhetit, i cili ishte 91%.</p> <p>Mirëpo ende mbetet klasifikimi i gabuar i shpenzimeve në kategori ekonomike.</p>	<p>Rekomandim pjesërisht i zbatuar.</p>
3	<p>Menaxhimi i personelit</p> <p>Çështja - Marrëveshjet kontraktuale dhe angazhimi i stafit në afat të caktuar.</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar. Në këtë mënyrë do të mënjanoen kërkesat për kontrata për shërbime të veçanta që mund të kalojnë periudhën e përcaktuar.</p>	<p>Menaxhmenti nuk ka ndërmarr asnjë veprim për eliminimin e kësaj dobësie, përkundrazi është shtuar numri i këtyre rasteve.</p>	<p>Rekomandim i pa zbatuar.</p>
4	<p>Mallra dhe shërbime</p> <p>Çështja - Monitorimi jo i duhur i marrëveshjes.</p>	<p>Kryetari, duhet të emërtojë mbikëqyrësit dhe të sigurojë se është pranuar një raport i detajuar mbi shërbimet e kryera në mënyrë që të shtojë sigurinë tek menaxhmenti se marrëveshjet po realizohen konform kushteve të kontraktuara.</p>	<p>Menaxhmenti ka vendosur një mbikëqyrës, por nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër për eliminimin e kësaj dobësie. Vazhdon të mos ketë raportim të duhur, si dhe disa çështje të përcaktuara me marrëveshje nuk po zbatohen.</p>	<p>Rekomandim i zbatuar pjesërisht.</p>
5	<p>Investime Kapitale</p> <p>Mangësitë në procesimin e pagesave.</p>	<p>Kryetari, duhet të forcojë kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit. Po ashtu, duhet të rishikoj në mënyrë sistematike, arsyen e mos pagesës së faturave në baza mujore për t'i eliminuar të gjitha obligimet brenda afatit ligjor.</p>	<p>Këtë çështje ne e kemi trajtuar dhe nuk kemi hasur raste të tilla gjatë auditimit.</p>	<p>Rekomandim i zbatuar.</p>

6	Investime Kapitale Çështja - Mos zbatimi i planit dinamik për realizimin e punimeve.	Kryetari, duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve i nënshtrohet një analize reale të kapaciteteve të komunës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare dhe kërkesat ligjore. Kontrollat në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuar me qëllim të arritjes së objektivave të komunës brenda afateve kohore dhe fondeve të planifikuara.	Gjatë auditimit të pagesave për investime kapitale nuk kemi gjetur çështje të tilla që kanë ndodhur në vitin paraprak prandaj themi që është zbatuar rekomandimi.	Rekomandim i zbatuar.
7	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale. Çështja mos aplikimi i sistemit e-pasuria.	Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.	Nga viti i kaluar kemi vërejtur se ekzistojnë probleme në menaxhimin e pasurive dhe kjo çështje ka vazhduar edhe në këtë vit.	Rekomandim i pa zbatuar.
8	Të arkëtueshmet Çështja - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme.	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollat në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe të jenë më efikas në procesin e arkëtimit të tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.	Nga auditimi kemi vërejtur se borxhet e debitorëve ndaj komunës vazhdojnë të rriten, prandaj themi se nuk ka pasur përmirësim.	Rekomandim i pa zbatuar.
9	Progresi i zbatimit të rekomandimeve Çështja - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm.	Kryetari, duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimet, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
10	Sistemi i auditimit të brendshëm Çështja - Niveli i ultë i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së.	Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimet për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësisve administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.	Nga auditimi ynë nuk kemi vërejtur ndonjë përmirësim të gjendjes në këtë çështje.	Rekomandim i pa zbatuar.

11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut Çështja - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut.	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	Nga auditimi ynë nuk kemi vërejtur ndonjë përmirësim të gjendjes në këtë çështje, prandaj kemi konfirmuar se gjendja mbete e njejtë.	Rekomandim i pa zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV dhe opinioni i auditimit.	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim/theksim në opinionin e auditimit dhe të çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në shpalosjen e saktë të vlerës së pasurive, detyrimeve kontingjente dhe llogarive të arkëtueshme në PFV. Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2019, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Pagesat direkte nga Thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore.	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i shpenzimeve për tu siguruar se ato kryhen sipas afateve ligjore për të evituar shpenzimet shtesë përmes procedurave gjyqësore.		
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve.	Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari për të evituar një raportim dezorientues për shfrytëzuesit e PFV-ve.		
4	Paga dhe Mëditje Pagesa e Këshilltarëve përmes angazhimit me kontratë për shërbime të veçanta.	Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar. Në këtë mënyrë do të mënjanohej kërkesat për kontrata për shërbime të veçanta që mund të kalojnë periudhën e përcaktuar.		

5	Mallra dhe shërbime. Moszbatimi i marrëveshjes.	Kryetari, duhet të sigurojë monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes, ashtu që të ketë një raport të detajuar mbi shërbimet e kryera në mënyrë që të shtojë sigurinë tek menaxhmenti se marrëveshjet po realizohen konform kushteve të kontraktuara. Në anën tjetër, kryetari duhet të siguroj doemos, që për zbatimin e marrëveshjes të siguroj mjetet e mjaftueshme buxhetore me rastin e planifikimit të buxhetit, në të kundërtën marrëveshja si e tillë nuk mund të jetë e zbatueshme sipas rregullave të përcaktuara buxhetore.
6	Pasuria kapitale dhe jo kapitale.	Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.
7	Të arkëtueshmet.	Kryetari duhet të analizojë arsyet për trendin në rritje të arkëtueshmeve të tatimit në pronë dhe për të forcuar kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Është e nevojshme të krijohet një strategji dhe mekanizma për të mundësuar identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluar përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në evidencën e tatimit në pronë të paguar. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë llogaritë e arkëtueshme të taksës së biznesit, në mënyrë adekuate.
8	Sistemi i AB.	Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.
9	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut.	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.



---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk

---

ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

#### Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Graçanicës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Srdjan Popoviq .....

Kryetar i Komunës së Graçanicës

Data: 15.Prill.2019, Graçanicë,

